LIGJ
Nr. 114/2017

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 93/2015, "PËR TURIZMIN"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 93/2015, "Për turizmin" bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në nenin 4, "Përkufizime", pas pikës 52 shtohen pikat 53, 54 dhe 55 me këtë përmbajtje:

"53. "Strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, status special" nënkupton strukturën akomoduese, që përfshin hotelin dhe/ose resortin me 4 ose 5 yje, e cila përmbush kriteret e përcaktuara në nenin 33/2 të këtij ligji.

54. "Investitor në strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, status special" nënkupton subjektin, i cili financon ndërtimin dhe/ose merr përsipër ndërtimin e strukturave akomoduese me 4 ose 5 yje, status special, në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, i cili përmbush kriteret e përcaktuara në nenin 33/1 të këtij ligji.

55. "Operator menaxhues në strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, status special" nënkupton grupin hotelier, i cili merr përsipër operimin dhe menaxhimin e një strukture akomoduese me 4 ose 5 yje, status special, drejtpërdrejt apo nëpërmjet kontratave "*franchising*" apo kontratave të tjera, të ngjashme me këtë të fundit.".

Neni 2

Pas nenit 33 shtohen nenet 33/1 dhe 33/2 me këtë përmbajtje:

"Neni 33/1

Investitor në strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, status special

Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për turizmin, jep statusin e veçantë "Investitor në strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, status special" për subjektin që plotëson të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) është investitor në një strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, në Republikën e Shqipërisë, të certifikuar si e tillë nga struktura përgjegjëse, sipas këtij ligji;

b) vlera e investimit është të paktën 8 milionë euro për ndërtimin e strukturës akomoduese me 4 yje dhe të paktën 15 milionë euro për ndërtimin e strukturës akomoduese me 5 yje.

Neni 33/2

Aplikimi për statusin "Investitor në strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, status special" dhe marrëveshja me investitorin

1. Kriteret e tjera, procedurat dhe dokumentacioni që duhet të plotësojnë subjektet që duan të aplikojnë për statusin "Investitor në strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, status special" përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për turizmin.

2. Subjektet, që përfitojnë statusin "Investitor në strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje,

status special" nënshkruajnë marrëveshje zhvillimi me ministrinë përgjegjëse për turizmin, në të cilën parashikohen detyrimet e ndërsjella, afatet e realizimit të projektit, vlera e projektit, ndalimet për tjetërsimin e pronësisë së strukturave të ndërtuara apo pjesëve të tyre, si dhe pasojat nga mosrespektimi i detyrimeve të ndërsjella.".

Neni 3

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 9 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të pikës 1 të nenit 33/2.

Neni 4

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 18.12.2017

Shpallur me dekretin nr. 10705, datë 26.12.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta